

Manuali i përdorimit

Regjistrimi si biznes dhe aplikimi për vulë elektronike

1. Hyrje

- **Qka është rTrust?**

rTrust është autoritet certifikues për lëshimin e nënshkrimit elektronik, vulës elektronike, certifikatës elektronike, identitetit digjital për qytetarë, biznese dhe ueb server, konform kornizës ligjore në fuqi në vendin tonë si dhe eIDAS Rregullores 910/2014 të BE-së, e cila përcakton standartet për shërbimet e besueshme elektronike.

- **Qellimi i manualit**

Ky manual është krijuar për të udhëhequr bizneset përmes procesit të regjistrimit në platformën tonë dhe për të ndihmuar në procesin e aplikimit për një vulë elektronike.

Duke ndjekur këtë udhëzues hap pas hapi, do të jeni në gjendje të:

1. **Regjistroheni si përdorues:** Kuptoni hapat e nevojshëm dhe informacionin e kërkuar për të krijuar me sukses një llogari biznesi në platformën rTrust.
2. **Aplikoni për vulë elektronike:** Mësoni se si të aplikoni për vulë elektronike, duke përfshirë dorëzimin e dokumenteve dhe informacionit të nevojshëm.

Ky manual synon t'i bëjë proceset e regjistrimit dhe aplikimit sa më thjeshtë që të jetë e mundur, duke siguruar që ju të mund të vendosni shpejt dhe lehtë biznesin tuaj në platformën tonë dhe të përfitoni nga vula elektronike për nevojat e biznesit tuaj.

Nëse hasni ndonjë problem ose keni nevojë për ndihmë të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni ekipin tonë të mbështetjes duke përdorur informacionin e dhënë në fund të këtij manuali.

2. Procesi i regjistrimit hap pas hapi

- **Hapi 1: Qasja në platformë**

Për të hyrë në Platformë, duhet të përdorni url-në e mëposhtme nga një shfletues në një kompjuter personal ose një pajisje celulare (tablet ose smartphone): <https://rtrust.org>




Figura 1. Faqja kryesore

- Hapi 2: Mbani kursorin mbi opsionin **Zgjidhjet** dhe klikoni shërbimin e dëshiruar.




Figura 2. Zgjedhja e shërbimit të dëshiruar

- Hapi 3: Pasi klikoni në **Biznes** ju shfaqet një dritare e re në të cilën është mundësia të aplikoni si Biznes për vulë elektronike.

Klikoni **Apliko këtu**.




Figura 3. Apikimi për vulë elektronike

- **Hapi 4:** Plotësoni të gjitha informatat e kërkuara në këtë formë, të dhënat duhet të jenë **reale**. Pajtohuni me kushtet e kontratës dhe klikoni butonin **Vazhdo**.




Figura 4. Forma e aplikimit për vulë elektronike

- **Hapi 5:** Në faqen që shfaqet ju paraqiten të dhënat që i keni ofruar në formën paraprake. Për të vazhduar tutje ju duhet të ngarkoni:

1. foton e përparme të ID-së suaj
2. foton e prapme të ID-së suaj
3. foton tuaj duke mbajtur ID tuaj ne dorë
4. foton e faturës (energjisë elektrike ose ujit) ku figuron adresa juaj
5. foton e certifikatës së biznesit tuaj
6. vërtetimin e personit të autorizuar për të marrë vulën elektronike

**Të gjitha dokumentet e kërkuara në këtë formë janë të detyrueshme për të vazhduar aplikimin!*




Figura 5. Ngarkimi i dokumenteve të verifikimit

Pas ngarkimit të imazheve të kërkuara dhe klikimit të butonit **Vazhdo**, ju do të pranoni një email për verifikim të adresës suaj elektronike nga ekipi rTrust, në emailin që e keni ofruar gjatë regjistrimit.

- **Hapi 6:** Verifikoni email adresen tuaj duke klikuar në butonin **Verifiko emailin**.



I/e nderuar John ,

Sapo keni aplikuar për t'u pajisur me një certifikatë dixhitale nga rTrust.
Për të përfunduar me sukses aplikacionin, ju lutemi klikoni në lidhjen më poshtë për të verifikuar adresën tuaj të emailit.

[Verifiko emailin](#)

Nëse nuk keni aplikuar për certifikatë, ju lutemi shpërfilleni këtë email.

Përshëndetjet më të mira,
Ekipa e rTrust

UKITES BY PBC LIMITED - SLOTES
Kotnikova Ulica 5, 1000 Ljubljana, SLOVENIA

Figura 6. Konfirmimi i emailit

- **Hapi 7:** Pas verifikimit të adresës suaj elektronike, ju duhet të prisni emailin me vendimin për aplikimin tuaj nga ekipi i rTrust.
- **Hapi 8:** Klikoni në linkun që ekipi i rTrust ju dërgon të bashkangjitur në email së bashku me vendimin.



Figura 8. Emaili me vendimin e aplikimit për certifikatë

- **Hapi 9:** Pasi klikoni në link, ju shfaqet një faqe e re në të cilën duhet të klikoni në butonin **Paguaj tani**.

Informatë

Faleminderit që keni zgjedhur të blini vulën elektronike nga rTrust. Për të vazhduar tutje, ju duhet të kryeni pagesën elektronike, përmes kartelave të debitit ose kreditit në platformën IBAS.

IBAS është institucion financiar i licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës për shërbimin e pagesave, transfereve, kredidhënies dhe këshillimit për investime në instrumente financiare, siç janë aksionet, obligacionet, letrat tregtare.




Figura 9.

- **Hapi 10:** Në vazhdim ju shfaqet forma e pagesës të cilën duhet ta mbushni me të dhënat e kartelës tuaj dhe të klikoni **Konfirmo**.

Figura 10. Forma për pagesë

- **Hapi 11:** Pas përfundimit të pageses me sukses, ju do të pranoni një email nga ekipi i rTrust.



I/E nderuar John,

Urime! Vula juaj elektronike tani është gati për përdorim. Për ta aktivizuar, ju lutemi krijoni një fjalëkalim të fortë dhe unik. Ky fjalëkalim do të jetë thelbësor për vulosjen e dokumenteve tuaja ose autentikimin në webfaqet e partnerëve me të cilët ne kemi marrëveshje.

Për të përfunduar këtë proces dhe për të pasur çasje në certifikatën tuaj dixhitale, thjesht klikoni [këtu](#)

Detaje të mëtejshme do të jepen gjatë hapave të ardhshëm.

Përshëndetjet më të mira,
Ekipi rTrust.

UKITES BY PBC LIMITED - SLOTES
Kotnikova Ulica 5, 1000 Ljubljana, SLOVENIA

Figura 11. Email nga ekipi i rTrust

- **Hapi 12:** Vendosni fjalëkalimin dhe klikoni butonin **Vazhdo**.

Krijoni fjalëkalimin tuaj

I/E nderuar Serafina,

Pas email-it tonë të mëparshëm, tani është koha për të krijuar dhe aktivizuar fjalëkalimin. Ju lutemi mbajeni fjalëkalimin tuaj privat dhe mos e ndani atë me të tjerët. Nëse e humbni fjalëkalimin, do të iu duhet ta përsërisni këtë proces pasi ne nuk i ruajmë fjalëkalimet për shkaqe sigurie.

Shkruani fjalëkalimin tuaj këtu...

Rishkruaj të njëjtin fjalëkalim këtu...

Vazhdo

Figura 12. Forma për krijimin e fjalëkalimit

Vëmendje: Ne nuk e ruajmë fjalëkalimin tuaj në sistemin tonë. Fjalëkalimi juaj nuk mund të ndryshohet ose përmirësohet në të ardhmen. Përgjegjësia për menaxhimin e fjalëkalimit bie tërësisht mbi ju. Prandaj, është e rëndësishme që ta ruani atë në një vend të sigurt. Ta keni parasysh se fjalëkalimi nuk mund të rikrijohet dhe duhet nisur përsëri procesin e aplikimi nga fillimi për certifikatë të re.

- **Hapi 13:** Pasi të krijoni fjalëkalimin me sukses, shfaqet kjo fushë me informata se si mund të përdoret certifikata.

Përgëzime!

I/E nderuar Serafina,

ID-ja juaj digjitale dhe nënshkrimi elektronik ose vula elektronike janë aktivizuar me sukses.

Mund t'i përdorni në dy mënyra:

- 1. Online:** Kyquni në platformën tonë të enkriptuar www.rtrust.org, duke klikuar [këtu](#). Ngarkoni dokumente për të nënshkruar vetë ose ftoni të tjerët të nënshkruajnë.
- 2. Offline:** Shkarkoni certifikatat duke klikuar [këtu](#) dhe instaloni ato në kompjuterin tuaj. Do t'ju duhet RAR Extractor, të cilin mund ta merrni duke klikuar [këtu](#).

Sa herë që keni nevojë për mbështetjen tonë, mos ngurroni të na kontaktoni përmes certificates@rtrust.org.

Gjithë të mirat,

Ekipi rTrust

UKITES BY PBC | SLOTES Kotnikova Ulica 5, 1000 Ljubljana, SLOVENIA

3. Informacioni i kontaktit për mbështetje

Email: certificates@rtrust.org.

Numri i telefonit: +383 49 247 857.

3.1 Personi kontaktues për mbrojtjen e të dhënave personale

Endrina Ramadani

Email: info@rtrust.org